



Ushqim
Organik

Mbrojtja
e
Bimëve

Përgatitja
e Dheut

Teori
dhe
Praktikë

Thirrje për aplikim

Kopshti Urban Programi Edukativ

Informata mbi kursin

Tulla Culture Center në bashkëpunim me Departamentin e Hortikultures dhe Arkitektures së Peisazhit në Universitetin Bujqësor të Tiranës hap thirrjen për aplikim në modulin Kopshtaria Urbane, ku do të trajtohet projektimi i hapësirave të gjelbërta urbane, krijimi i kopshteve të vogla në veranda, tarraca si dhe hapësira të tjera vertikale. Në fund të praktikës, të gjithë pjesëmarrësit do të mund të mësojnë të projektojnë kopshtet e veta, duke zbatuar parime të dizajnit të peisazhit dhe duke u njohur me bimët që i përshtaten më së miri kushteve urbane. Në përfundim të praktikës, çdo pjesëmarrës i sukseshëm do të pajiset me certifikatën e ofruar nga Tulla dhe UBT.

Programi

- Projektim peisazhi në kushtet e tarracës, verandës apo ballkonit
- 5 Parime të dizajnit të peizazhit
- Krijimi i koncept idesë për projektim kopshti
- Bimët dhe kompozimi bimor (mirëmbajtja dhe kostot)
- Përdorimi i bimëve të egra në kompozim
- Krijimi i kopshteve të vogla në vazo

Tulla – Culture Center do t'iu mundësojë pjesëmarrësve shfrytëzimin e laboratorit të kopshtarisë në tarracën e qendrës për praktikën, si dhe ambientet e

brëndshme për të punuar dhe projektuar.

Eksperti

Drejtimi i praktikës “Kopshtari Urbane” do të udhëhiqet nga **Silvi Jano**, lektor i Arkitekturës së Peisazhit në UBT, me një përvojë prej tetë vitesh në projektimin dhe kujdesin e kopshteve urbane.

Kërkesat dhe Kushtet e regjistrimit

Ky program ofrohet për pjesëmarrësit nga mosha 18 e sipër.

Tarifa e kursit: 6000 lekë

Tarifa e reduktuar për studentë: 3000 lekë

Pajisja me çertifikata.

Kohëzgjatja

6 javë / 5 ditë në javë

E hënë dhe e martë – 18:00 – 20:00, ditë pune të detyrueshme në qendër .

E mërkurë – 18:00 – 21:00, punë e pavarur.

E enjte e premte – konsulta online me ekspertin.

Kontakt

Afati i aplikimit: 8 Prill 2024

Për më shumë informacion na shkruani në:

education@tulla.tv

[Aplikacionet janë mbyllur!](#)



Lajme dhe Media

[Galeria](#)

[Aktivitetet](#)

Për ne

[Apliko – Moduli I](#)

[Apliko – Moduli II](#)

[Kontakti](#)

[Për ne](#)

Tulla Urban Farming © 2021 / Produced by: BGStudio